

**VENDIM**  
**Nr.14, datë 7.1.2009**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR  
REGJISTRIMIN NDËRKOMBËTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7 e 9 të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994 “Për aviacionin civil shqiptar”, të nenit 18 të konventës “Mbi garancitë ndërkombëtare në pajisjet e lëvizshme”, dhe të neneve 19 e 20 të protokollit të konventës “Mbi garancitë ndërkombëtare në pajisjet e lëvizshme, në lidhje me çështje specifike për pajisjet e mjeteve të fluturimit”, miratuar me ligjin nr.9551, datë 5.6.1006, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullave dhe të procedurave për regjistrimin ndërkombëtar, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, nën cilësinë e “Pikës hyrëse”, (Pikë autorizuese e hyrjes), për shtetin shqiptar, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



## RREGULLORET

### SEKSIONI 1 AUTORITETI

Këto "Rregullore" nxirren nga autoriteti mbikëqyrës sipas nenit 17 (2) (d) të Konventës mbi interesat ndërkombëtare në pajisjet e lëvizshme, nënshkruar në Keip Taun më 16 nëntor 2001 (Konventa) dhe nenit XVIII të protokollit të konventës mbi interesat ndërkombëtare në pajisjet e lëvizshme për çështjet specifike për pajisjet e avionëve, nënshkruar në Keip Taun më 16 nëntor 2001 (protokollin).

### SEKSIONI 2 PËRKUFIZIMET

2.1 Termat e përkufizuar në Konventë dhe protokoll do të kenë të njëjtat kuptime në këto rregullore. Veç kësaj, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e parashtruara më poshtë.

2.1.1 "Administrator" do të thotë personi që ka autoritetin për të vepruar në emër të një enti përdorues të regjistrit për çështje administrative në marrëveshjet me regjistrin ndërkombëtar dhe "administrator veprues" ka kuptimin e parashtruar në seksionin 4.1.

2.1.2 "Autorizim" do të thotë autorizimi elektronik i dhënë prej administratorit të një enti përdorues transaksioni për përdoruesit e tij të transaksionit ose për një përdorues profesional që t'i transmetojë informacion Zyrës Ndërkombëtare të Regjistrimit, për të kryer ose për të dhënë pëlqimin për një regjistrim në emër të atij enti përdorues të transaksionit.

2.1.3 "Pëlqim" do të thotë pëlqimi elektronik për një regjistrim.

2.1.4 "Identitet" do të thotë emri, adresa dhe adresa elektronike e entit ose e personit në lidhje me të cilin kërkohet informacioni identifikues.

2.1.5 "Palë e emërtuar" do të thotë enti përdorues i transaksionit i emërtuar në një regjistrim dhe "përfaqësues i emërtuar" do të thotë një person i emërtuar në një regjistrim dhe që vepron për të tjerët në një agjenci, trust ose me një cilësi tjetër përfaqësuese.

2.1.6 "Enti përdorues profesional" do të thotë një firmë ose një grupim tjetër personash (i tillë si departamenti ligjor i brendshëm i një enti përdorues transaksioni), që kryejnë shërbime profesionale për entet përdoruese të transaksionit në lidhje me transmetimin për zyrën e regjistrimit ndërkombëtar të informacionit që lidhet me regjistrimet dhe "përdorues profesional" do të thotë një punonjës i veçantë, anëtar ose partner i një enti përdorues profesional.

2.1.7 "Regjistrim" do të thotë një interes i regjistruar në mënyrë elektronike në regjistrin ndërkombëtar. Për qëllimet e seksionit 4.4 dhe 6, termi ka kuptimin e zgjeruar të parashtruar në seksionin 6.1. "Person që regjistrohet" do të thotë përdoruesi i transaksionit, përdoruesi profesional ose pika direkte e hyrjes që transmeton informacionin për Zyrën Ndërkombëtare të Regjistrimit për të kryer regjistrimin.

2.1.8 "Enti përdorues i regjistrit" do të thotë:

- a) një ent përdorues i transaksionit; ose
- b) një ent përdorues profesional.

"Përdorues regjistri" do të thotë një përdorues i transaksionit ose një përdorues profesional.

2.1.9 "Personi kërkues" do të thotë një person që bën një kërkim në përputhje me seksionin 7 të këtyre rregulloreve.

2.1.10 "Enti me qëllim special" do të thotë një ent biznesi, trust ose shoqatë e çfarëdo lloji, sido që të jetë themeluar, me cilësinë për t'u emërtuar në regjistrime, qëllimi i kufizuar i të cilit është që të hyjë në një transaksion me të cilin lidhen këto regjistrime, kur një ent

përdorues i transaksionit vërteton në mënyrë elektronike se ai kontrollon, menaxhon ose administron atë ent biznesi, trust ose shoqatë.

2.1.11 "Enti përdorues i transaksionit" do të thotë një ent ligjor ose person fizik që synon të bëhet një palë e emërtuar në një ose më shumë regjistrime dhe "përdorues transaksioni" do të thotë një punonjës, anëtar ose partner i veçantë i entit përdorues i transaksionit ose një filial i atij enti.

2.2 Termi ose terma:

a) "Pikë hyrjeje", "pikë autorizuese e hyrjes", "pikë e drejtpërdrejtë e hyrjes" kanë kuptimin e parashtruar në seksionin 12.1;

b) "Procedurat e regjistrimit ndërkombëtar" ka kuptimin e parashtruar në seksionin 15.1;

c) "Kërkimi prioritar", "certifikata e kërkimit prioritar", "renditja e kërkimit për informacion", "kërkimi i shtetit kontraktues" dhe "certifikata e kërkimit të shtetit kontraktues" do të kenë kuptimet e parashtruara në seksionin 7.

### SEKSIONI 3 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

3.1 Zyra Ndërkombëtare e Regjistrimit krijohet si një ambient për të kryer dhe kërkuar regjistrimet sipas Konventës dhe protokollit.

3.2 Meqenëse Zyra Ndërkombëtare e Regjistrimit kryen vetëm njoftimin e regjistrimeve, faktet që janë në bazë të këtyre regjistrimeve ose interesave të regjistruara, do të përcaktojnë nëse regjistrimi futet në objektin e Konventës apo të protokollit. Pa e kufizuar sa më sipër, ndërkohë që nuk do të ketë ndonjë pengesë teknike për regjistrimin e të drejtave dhe interesave paraekzistuese apo të detyrave të tyre, këto regjistrime nuk do të kenë efekt ligjor sipas Konventës dhe protokollit, me përjashtim të rasteve kur me anë të një deklarate sipas nenit 60 (3) të Konventës, kërkohet regjistrimi për të.

Përmbajtja e këtij seksioni 3.2 do të shfaqet në mënyrë të dukshme nga Zyra Ndërkombëtare e Regjistrimit si një shënim i përgjithshëm paralajmërues.

3.3 Regjistruesi do të kryejë funksionet e specifikuar në Konventë, protokoll, këto rregullore dhe Procedura Ndërkombëtare të Regjistrimit.

3.4 Zyra Ndërkombëtare e Regjistrimit do të jetë e hapur 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, me përjashtim të rasteve të mirëmbajtjes që kryhet jashtë periudhave të ngarkesës maksimale ose të problemeve teknike apo të sigurisë siç parashikohen në Procedurat e Regjistrimit Ndërkombëtar.

3.5 Mbështetja teknike do t'u jepet personave regjistruarë, personave kërkues dhe administratorëve nga një zyrë ndihme e Zyrës Ndërkombëtare të Regjistrimit, e cila do të jetë e disponueshme 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, nëpërmjet telefonit ose postës elektronike siç parashikohet në Procedurat e Regjistrimit Ndërkombëtar.

3.6 Zyra Ndërkombëtare e Regjistrimit nuk mund të përdoret për qëllime të tjera përveç atyre të parashikuara në seksionin 3.1 dhe 3.2, me përjashtim të miratimit paraprak nga ana e autoritetit mbikëqyrës dhe duke iu nënshtuar kushteve të atij miratimi.

### SEKSIONI 4 AKSESI I ZYRËS NDËRKOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

4.1 Asnjë ent përdorues i zyrës së regjistrimit apo administrator i atij enti nuk do të ketë akses në Zyrën Ndërkombëtare të Regjistrimit nëse ai ent dhe administrator nuk miratohen fillimisht si të tillë nga ana e Regjistruarit dhe që nuk janë në përputhje me këto rregullore dhe Procedurat e Regjistrimit Ndërkombëtar në ndonjë mënyrë tjetër. Për qëllimet

e fjalisë paraardhëse, ky miratim do të jepet kur regjistruesi nxjerr përfundimin në mënyrë të arsyeshme se:

a) ky ent dhe administratori janë ata që pretendojnë të jenë dhe

b) mbi bazën e informacionit të paraqitur dhe pa ndërmarrë një analizë ligjore specifike, se ky i fundit ka të drejtën të veprojë si administrator i entit, në çdo rast, sipas standardeve dhe procedurave të parashikuara në procedurat e regjistrimit ndërkombëtar.

Një administrator mund t'ia delegojë të drejtat e tij/të saj në mënyrë elektronike një "administratori veprues" herë pas here për periudha që nuk kalojnë tre (3) muaj.

4.2 Asnjë përdorues i Zyrës së Regjistrimit nuk do të ketë akses në regjistrin ndërkombëtar nëse ai përdorues nuk miratohet fillimisht në mënyrë elektronike si i tillë nga ana e administratorit të entit përdorues të regjistrimit të subjektit dhe nuk është në përputhje me këto rregullore dhe Procedura Ndërkombëtare të Regjistrimit. Asnjë përdorues i miratuar i Zyrës së Regjistrimit nuk do të ketë të drejtë t'i transmetojë informacion Zyrës Ndërkombëtare të Regjistrimit për të kryer një regjistrim nëse ky përdorues nuk ka marrë fillimisht autorizim për ta mbrojtur këtë gjë. Për qëllimet e fjalisë pararendëse, ky miratim elektronik mund të jepet me diskrecionin e vetëm të administratorit përkatës dhe mund të revokohet nga ky administrator në çdo kohë.

4.3 Pavarësisht nga paragrafët paraardhës:

a) administratori i një enti përdorues të transaksionit të miratuar nga ana e regjistruesit mund të miratojë në mënyrë elektronike një ent me qëllim të veçantë si një ent përdorues transaksionesh; dhe

b) në këtë rast, të drejtat, kompetencat dhe detyrimet e administratorit të entit miratues të përdoruesve të transaksioneve dhe përdoruesve të tij të transaksioneve, përkatësisht, do të aplikohen në mënyrë të barabartë për miratues të përdoruesve të transaksioneve.

4.4 Duke iu nënshtruar këtyre rregulloreve dhe në përputhje me Procedurat e Regjistrimit Ndërkombëtar, një regjistrim mund të kryhet, me autorizim, nga një person regjistrues, në emër të entit përdorues që kryen transaksionet, i cili është një palë e emëruar për të kryer atë regjistrim sipas nenit 20 të Konventës dhe nenit III të protokollit.

4.5 Asnjë person kërkues nuk do të ketë akses në Zyrën Ndërkombëtare të Regjistrimit po qe se ai person fillimisht nuk është në përputhje me këto rregullore dhe Procedurat e Regjistrimit Ndërkombëtar.

## SEKSIONI 5

### INFORMACIONI I KËRKUAR PËR TË KRYER REGJISTRIMIN

5.1 Në mënyrë që të kryhet një regjistrim, përdorimi i informacionit elektronik i dhënë nga Zyra Ndërkombëtare e Regjistrimit që lidhet me objektin e avionëve është i detyrueshëm dhe kur ai jepet në këtë mënyrë, është mjeti i vetëm për të plotësuar kërkesat e seksionit 5.3 (c) (ii) deri tek (iv).

Për qëllimet e sa më sipër, "informacioni i dhënë nga Zyra Ndërkombëtare e Regjistrimit" e përjashton informacionin e paraqitur në format të ndryshëm nga personi regjistrues. Deri në masën që ky informacion nuk jepet kështu në kohën kur dorëzohen të dhënat e regjistrimit në Zyrën Ndërkombëtare të Regjistrimit, ai do të regjistrohet në mënyrë elektronike nga ana e një personi regjistrues duke përdorur formatin e parashikuar në Procedurat e Regjistrimit Ndërkombëtar, me përjashtim të palëve të emërtuara (të tjera nga ato të cilave nuk u kërkohet pëlqimi sipas seksionit 5.8), sepse ato duhet të jenë ente përdorues të miratuar të transaksioneve.

5.2 Informacioni për identitetin do të konsiderohet i plotë vetëm nëse jepet secili nga të tri elementet që përmban përkufizimi i identitetit.

5.3 Informacioni i kërkuar për të kryer regjistrimin e një interesi ndërkombëtar të ardhshëm, një interesi ndërkombëtar të përftuar nëpërmjet zëvendësimit, një njoftimi të një interesi kombëtar ose një të drejte apo interesi të regjistrueshëm jokonsensual është:

a) identiteti dhe nënshkrimi elektronik i personit regjistruar dhe një deklaratë se në emër të kujt vepron ai person;

b) identiteti i palëve të emërtuara;

c) informacioni i mëposhtëm që identifikon objektin e avionit:

i) tipi i objektit të avionit;

ii) emri i prodhuesit;

iii) emërtimi i përgjithshëm i modelit të prodhuesit; dhe

iv) numri serial i prodhuesit, që i jepet objektit të avionit;

d) në rastin e një korpusi avioni, informacioni i mëposhtëm, nëse dihet:

i) gjendja aktuale e regjistrimit dhe, nëse është e ndryshme, gjendja e regjistrimit që synohet për qëllimet e kombësisë; dhe

ii) kombësia aktuale dhe, nëse është e ndryshme dhe ajo e synuar e avionit, shenjat e regjistrimit të caktuara sipas Konventës së Çikagos;

e) kohëzgjatja e regjistrimit, nëse regjistrimi do të bëhet para depozitimit të një çregjistrimi;

f) në rastin e një interesi ndërkombëtar të ardhshëm, pëlqimi i palëve të emërtuara, dhënë sipas një autorizimi;

g) në rastin e një interesi ndërkombëtar të përftuar në bazë të zëvendësimit, numri i dosjes së regjistrimit të atij interesi; dhe

h) emrat dhe adresat elektronike të personave të cilëve regjistruar i kërkohet t'u dërgojë njoftime informacioni sipas seksionit 6.

5.4 Informacioni i kërkuar për të kryer regjistrimin e një kontrate shitjeje ose shitjeje të ardhshme është:

a) informacioni që përmendet në seksionet 5.3 (a) deri në (d) dhe 5.3 (h);

b) pëlqimi i palëve të emërtuara, i dhënë sipas një autorizimi; dhe

c) në rastin e një shitjeje të ardhshme, kohëzgjatja e regjistrimit, nëse ai regjistrim do të kalojë përpara kohës së një çregjistrimi.

5.5 Informacioni i kërkuar për të kryer regjistrimin e transferimit të një interesi ndërkombëtar, transferimin e ardhshëm të një interesi ndërkombëtar ose transferimin e një interesi të regjistrueshëm jokonsensual është:

a) informacioni që përmendet në seksionet 5.3 (a) deri te (d) dhe 5.3 (h);

b) pëlqimi i palëve të emërtuara i dhënë sipas një autorizimi;

c) nëse interesi që transferohet është interes i regjistruar, numri i dosjes së regjistrimit që lidhet me atë interes; dhe

d) nëse interesi që transferohet nuk është interes i regjistruar, përshkrimi i interesit të transferuar dhe debitorit origjinal sipas tij, duke përdorur formatin e parashikuar nga Procedurat e Regjistrimit Ndërkombëtar.

5.6 Informacioni i kërkuar për të kryer një regjistrim, që është i ndryshëm nga regjistrimi që lidhet me një kontratë shitjeje:

a) informacioni që përmendet në seksionet 5.3 (a) deri tek (d) dhe 5.3 (h) ;

b) pëlqimi i palëve të emërtuara që përfitojnë nga interesi i përftuar i dhënë sipas një autorizimi; por jo i debitorit, të transferuesit ose personit që ka në varësi interesin e regjistruar ose të shitësit të ardhshëm në rastin e një regjistrimi që lidhet me një shitje të ardhshme;

c) numri i dosjes së regjistrimit që do të anulohet; dhe

d) data kur çregjistrimi do të hyjë në fuqi.

5.7 Informacioni i kërkuar për të kryer regjistrimin e varësisë së një interesi ndërkombëtar, një interesi ndërkombëtar të ardhshëm, interesin kombëtar ose interesin e

regjistrueshëm jokonsensual është:

a) informacioni që përmendet në seksionet 5.3 (a) deri (d) dhe 5.3 (h), dhe për qëllimet e referencës së mëparshme deri në seksionin 5.3 (b) dhe për qëllimet e seksionit 5.7 (b) "palët e emërtuara" do të jenë entet përdoruese të regjistrimit që i ndërvarin interesat e tyre dhe përfitojnë nga kjo varësi;

b) pëlqimi i palës së emërtuar, interesi i së cilës futet në varësi, i dhënë sipas një autorizimi;

c) në qoftë se interesi që futet në varësi ose që përfiton nga varësia është një interes i regjistruar, numri i dosjes që lidhet me secilin prej këtyre interesave;

d) në qoftë se interesi që futet në varësi ose që përfiton prej varësisë nuk është një interes i regjistruar, një përshkrim i këtij interesi dhe debitorit origjinal sipas tij, duke përdorur formatin e parashikuar nga Procedurat Ndërkombëtare të Regjistrimit.

5.8 Pavarësisht nga seksioni 5.3 (f) 5.4 (b) dhe 5.5 (b), informacioni që nevojitet për të kryer regjistrimin e një të drejte ose interesi pararegjistrues ose një interesi që kërkohet sipas deklaratës së nenit 60 (3) të Konventës nuk ka nevojë të përfshijë pëlqimin e debitorit, të transferuesit, shitësit ose personit, që e nënshtron të drejtën ose interesin.

5.9 Informacioni, që kërkohet për të ndryshuar një regjistrim, i përcaktuar si çdo ndryshim ndaj informacionit që ai përmban, është:

a) informacioni që përmendet në seksionet 5.3 (a) deri (d) dhe 5.3 (h);

b) pëlqimi i palëve të emërtuara që kanë dhënë miratimin për regjistrimin që regjistrimi të ndryshohet, i dhënë sipas një autorizimi;

c) numri i dosjes së regjistrimit që do të ndryshohet; dhe

d) ndryshimet që do të bëhen.

5.10 Pa cenuar seksionin 12.6, mungesa e informacionit që përmendet në seksionin 5.3 (d), duke përfshirë referencën e kryqëzuar në seksionet e tjera, nuk e bën të pavlefshëm regjistrimin.

5.11 Kërkesat për pëlqimin të këtij seksioni 5 do të plotësojnë:

a) në rastin e regjistrimit të iniciuar prej një pike të drejtpërdrejtë hyrjeje në përputhje me seksionin 12.1 (b), kur Zyra e Regjistrimit Ndërkombëtar merr pëlqimin nga të gjitha palët prej të cilave kërkohet pëlqimi sipas Konventës, protokollit dhe këtyre rregulloreve; dhe

b) në rastin e një regjistrimi të autorizuar në përputhje me seksionin 12.1(a) në lidhje me palën paraqitëse kur Zyra Ndërkombëtare e Regjistrimit e merr një regjistrim të tillë së bashku me autorizimin.

5.12 Regjistrimi mund të specifikojë që:

a) ai mbulon një interes fraksional ose të pjesëshëm në një objekt avioni dhe nëse është kështu, shkallën e këtij interesi; dhe/ose

b) palët e shumta të emërtuara mbajnë ose kanë dhënë një interes të vërtetuar për këtë.

Kur një amendament i një regjistrimi të specifikuar në klauzolën (a) të kësaj rregulloreje ndryshon shkallën e një interesi, ai amendament hyn në fuqi prej dhe vetëm cenon interesat që lindin pas kohës së regjistrimit të ndryshuar.

## SEKSIONI 6 KONFIRMIMI DHE NJOFTIMI I REGJISTRIMIT

6.1 Në këtë seksion, termi "regjistrim" përfshin, aty ku duhet, amendimin, zgjerimin ose çregjistrimin e një regjistrimi.

6.2 Regjistruesi do të japë konfirmim të menjëhershëm elektronik për një regjistrim të palëve të emërtuara, të personit regjistrues dhe të të gjithë personave të tjerë, që kanë të drejtë të marrin njoftim për këtë regjistrim sipas seksionit 5.

Konfirmimi do të përmbajë informacionin e paraqitur në nenin 22 (2) (a) të

Konventës.

6.3 Kur kryhet një regjistrim, që lidhet me një objekt avioni, njoftimi për të do t'u dërgohet personave që përmenden në seksionin 6.2 në çdo regjistrim tjetër që lidhet me atë objekt.

6.4 Konfirmimi dhe njoftimi i përmendur në seksionet 6.2 dhe 6.3, përkatësisht, do të përfshijë informacionin e specifikuar në seksionin 5, që lidhet me to dhe numrin e dosjes së regjistrimit.

## SEKSIONI 7 KËRKIMET

7.1 Kërkimet e Zyrës Ndërkombëtare të Regjistrimit mund të kryhen kundrejt:

a) një emri të prodhuesit;  
b) një emërtimi modeli të përgjithshëm të prodhuesit ; dhe  
c) një numri serial të prodhuesit të një objekti avioni; dhe në rastin e një korpusi avioni ose një helikopteri:

d) gjendjes së regjistrimit të avionit, pjesë e të cilit ai është; ose

e) kombësia ose shenja e regjistrimit.

Ky informacion mund të kërkohet me anë të një kërkimi prioritar ose të një kërkimi informativ, siç përcaktohet përkatësisht në seksionet 7.2 dhe 7.3.

Një kërkim i një shteti kontraktues mund të bëhet siç përcaktohet në seksionin 7.5.

Një kërkim mund të kryhet prej çdo personi që përputhet me Procedurat e Regjistrimit Ndërkombëtar, qoftë kur ai person kërkues ka ose nuk ka interes specifik. Të gjitha kërkimet do të kryhen me anë të mjeteve elektronike.

7.2 Një "kërkim prioritar" është një kërkim për informacion regjistrimi, që përdor të tri kriteret e specifikuar në nenin XX (1) të protokollit, siç përcaktohet në seksionin 7.1 (a) deri (c). Ky informacion është i kërkueshëm për qëllimet e neneve 19 (2) dhe (6) të Konventës dhe nenit XX (1) të protokollit.

7.3 Një "kërkim informativ" është një kërkim i ndryshëm nga kërkimi prioritar, që përdor kriterin e parashtruar në seksionin 7.1 (c) ose kur disponohet në Zyrën Ndërkombëtare të Regjistrimit, seksioni 7.1 (e), në secilin rast më vete ose me një kriter tjetër të përcaktuar në atë seksion. Këto kërkime informative mund të përfshijnë përdorimin e simboleve të specifikuar në Zyrën Ndërkombëtare të Regjistrimit të planifikuara për të prodhuar kërkime rezultate kërkimi përfshirëse. Rezultatet e një kërkimi informativ, një "renditje e kërkimit informativ" do të jetë një listë e të gjithë objekteve të kombinuara të avionit, të përshkuara nga zërat e përcaktuar në seksionin 7.1 (a) deri (c) dhe, nëse disponohet në Zyrën Ndërkombëtare të Regjistrimit, zërat në seksionin 7.1 (d) deri (e).

Lehtësia për kryerjen e këtij kërkimi informativ nuk e bën atë informacion "të kërkueshëm" për qëllimet e nenit 19 (2) dhe (6) të Konventës dhe nenit XX (1) të protokollit.

7.4 Një "certifikatë kërkimi prioritar" është një certifikatë që lëshohet në përgjigje të një kërkimi prioritar.

Ajo:

a) do të parashtrorë informacionin e kërkuar nga neni 22 (2) (a) ose (b) të Konventës, siç aplikohet, dhe në përputhje me nenin 22 (3) të Konventës ; dhe

b) në rastin kur aplikohet neni 22 (2) (a) i Konventës, do të rendisë informacionin e regjistruar si në:

i) rendin kronologjik; dhe

ii) në mënyrë që të tregojë historinë e transaksioneve të çdo interesi të regjistruar.

7.5 Një "kërkim i shtetit kontraktues" është një kërkim për të gjitha deklaratat dhe



emërtimet, dhe tërheqjet e tyre të bëra sipas Konventës dhe protokollit nga ana e shtetit kontraktues të specifikuar në kërkim. Një "certifikatë kërkitimi e shtetit kontraktues" është një certifikatë e lëshuar në përgjigje të kërkitimit të një shteti kontraktues.

Certifikata e kërkitimit të shtetit kontraktues:

a) të tregojë në rend kronologjik të gjitha deklaratat dhe emërtimet për tërheqjen e tyre, nga ana e shtetit kontraktues të specifikuar;

b) të rendisë datën e hyrjes në fuqi të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në Konventë dhe protokollit dhe të çdo deklaratë apo emërtimi dhe tërheqjeje të tyre nga ana e shtetit kontraktues të specifikuar; dhe

c) të bashkëlidhë në formën elektronike të parashikuar në Procedurat Ndërkombëtare të Regjistrimit, një kopje të të gjitha instrumenteve të depozituara nga shteti kontraktues i specifikuar, që lidhet me zërat që përfshin objekti i seksionit 7.5 (b).

7.6 Secila certifikatë kërkitimi dhe renditjeje do të lëshohet dhe do të vihet në dispozicion në formë elektronike. Sipas kërkesës, regjistruesi do të japë një kopje të printuar të certifikatës së kërkitimit prioritar ose të certifikatës së kërkitimit të shtetit kontraktues.

## SEKSIONI 8 ANKESAT OPERACIONALE

8.1 Çdo person mund të paraqesë një ankesë te regjistruesi në lidhje me operacionin e Zyrës Ndërkombëtare të Regjistrimit. Nëse nuk trajtohet në mënyrë të kënaqshme nga regjistruesi, ajo ankesë mund të paraqitet më tej nga ai person tek autoriteti mbikëqyrës.

8.2 Për qëllimet e seksionit 8.1, një çështje "ka lidhje me operacionin e Zyrës Ndërkombëtare të Regjistrimit", kur çështja lidhet me procedurat dhe politika të përgjithshme të Zyrës Ndërkombëtare të Regjistrimit dhe nuk përfshin gjykim specifik nga ana e regjistruesit ose autoritetit mbikëqyrës.

8.3 Personi që bën një ankesë do t'i paraqesë pohimet e tij/të saj me shkrim.

8.4 Autoriteti mbikëqyrës do të shqyrtojë ankesat dhe mbi bazën e këtij shqyrtimi, ai vendos nëse ndryshimet e procedurave dhe politikave janë të përshtatshme, për këto ai do të udhëzojë regjistruesin.

8.5 Procedurat e Zyrës Ndërkombëtare të Regjistrimit do të përcaktojnë detaje që lidhen me procedurën e parashikuar nga seksionet 8.1 deri në 8.4.

## SEKSIONI 9 KONFIDENCIALITETI

Të gjitha informacionet në zyrën ndërkombëtare të regjistrimit do të jenë konfidenciale, me përjashtim të rasteve kur:

- a) jepen nga regjistruesi në përgjigje të një kërkitimi sipas seksionit 7;
- b) bëhen në formë elektronike të disponueshme për t'u mundësuar përdoruesve të regjistrimit që të kryejnë, ndryshojnë ose çregjistrojnë regjistrimet;
- c) jepen nga autoriteti mbikëqyrës me kërkesën e këtij të fundit; ose
- d) përdoren për qëllimet e statistikave të kërkuara nga seksioni 10.

## SEKSIONI 10 STATISTIKAT

10.1 Regjistruesi do të mbajë statistikatat e regjistrimit të përditësuara dhe do t'i publikojë ato në një raport vjetor. Ky raport do të bëhet i disponueshëm për çdo person në

mënyrë elektronike.

10.2 Statistikat e regjistrimit sipas seksionit 10.1 do të konsistojnë në:

- a) volumet e transaksioneve dhe të ardhurat e nëndara në çdo rast sipas llojit të regjistrimit dhe shpërndarjes gjeografike; dhe
- b) përpilime të tjera të informacioneve jo konfidenciale të kërkuara autoriteti mbikëqyrës.

## SEKSIONI 11 RAPORTI VJETOR PËR AUTORITETIN MBIKËQYRËS

Regjistruesi do të përgatisë një raport vjetor që përfshin të dhëna statistikore të cilat përmenden në seksionin 10 dhe do t'ia paraqesë atë autoritetit mbikëqyrës.

## SEKSIONI 12 MARRËDHËNIET ME PIKAT E HYRJES

12.1 Një shtet kontraktues mund të caktojë një pikë hyrjeje ose disa pika hyrjeje (pika e hyrjes) sipas nenit XIX (1) të protokollit:

a) e cila do të ose mund të autorizojë transmetimin e informacionit të kërkuar për regjistrim sipas Konventës dhe protokollit në Zyrën Ndërkombëtare të Regjistrimit (pika autorizuese e hyrjes); ose

b) nëpërmjet së cilës informacioni i kërkuar për regjistrim sipas Konventës dhe protokollit do të mund të transmetohet drejtpërdrejt te Zyra Ndërkombëtare e Regjistrimit (pika e drejtpërdrejtë e hyrjes).

12.2 Një shtet kontraktues mund të caktojë vetëm një pikë hyrjeje të detyrueshme në lidhje me:

a) regjistrimet që lidhen me korpus avioni dhe helikopterët për të cilët ai është shteti i regjistrimit; dhe/ose

b) regjistrimet e interesave ndërkombëtarë të ardhshëm, shitjeve të ardhshme ose transferimeve të ardhshme të interesave ndërkombëtarë në ndonjë korpus avioni ose helikopter për të cilën ai ka marrë hapa rregullatorë për tu bërë shtet i regjistrimit.

12.3 Një shtet kontraktues që cakton një pikë hyrjeje do ta njoftojë depozitarin dhe autoritetin mbikëqyrës për këtë, duke treguar nëse kjo pikë hyrjeje është një pikë autorizuese e hyrjes apo e drejtpërdrejtë. Autoriteti mbikëqyrës do ta informojë regjistruesin për këto caktime dhe regjistruesi do të mbajë një listë aktuale për to, që vihet në dispozicion të përdoruesve në formë elektronike.

12.4 Regjistruesi do të bëjë rregullimet e aplikueshme për transmetimin elektronik të informacionit të regjistrimit prej ose autorizuar prej pikave të hyrjes për Zyrën Ndërkombëtare të Regjistrimit dhe, pas konsultimeve me secilën pikë hyrjeje të caktuar, do të specifikojë procedurat e aplikueshme për atë pikë hyrjeje. Sa më sipër, nuk do të kërkojë krijimin e sistemeve të koordinuara në mënyrë elektronike, por në vend të tyre rregullime të caktuara për të rritur përdorimin efikas të Zyrës Ndërkombëtare të Regjistrimit nga ana e pikave të hyrjes.

12.5 Zyra Ndërkombëtare e Regjistrimit do të bëjë një paralajmërim elektronik kundër një regjistrimi që nuk është kryer:

a) nëpërmjet një pike hyrjeje të drejtpërdrejtë ku përdorimi i tij është i detyrueshëm; ose

b) në përputhje me procedurat e kërkuara nga një pikë hyrjeje autorizuese; deri në

masën e rënë dakord midis Zyrës Ndërkombëtare të Regjistrimit dhe Shtetit Kontraktues duke deklaruar atë pikë hyrjeje.

12.6 Një regjistrim i kryer duke shkelur kushtet e caktimit sipas seksioneve 12.1 dhe 12.2, është i pavlefshëm.

### SEKSIONI 13 PAGESAT

13.1 Regjistruesi do të mbledhë pagesën para ndërmarrjes së shërbimeve që lidhen me Zyrën Ndërkombëtare të Regjistrimit.

13.2 Pagesat që përfshijnë pagesat të cilat lindin nga operacionet nëpërmjet një pike hyrjeje duhet t'i paguhet regjistruesit para operacionit të kërkuar, me përjashtim të rastit kur bie dakord ndryshe midis regjistruesit dhe kësaj pike hyrjeje.

13.3 Pagesat do të mblidhen në përputhje me një tabelë të lëshuar nga autoriteti mbikëqyrës, e cila do të deklarojë shumën e pagesave që duhen kryer për çdo shërbim.

13.4 Pagesat do të vendosen dhe do të rregullohen nga autoriteti mbikëqyrës, siç kërkohet nga Konventa dhe protokollit.

### SEKSIONI 14 PËRGJEGJËSIA DHE SIGURIMI

14.1 Për qëllimet e nenit 28 (1) të Konventës, "humbje e pësuar" do të thotë humbje ose dëmtim që rezulton nga një gabim ose neglizhencë e regjistruesit dhe zyrtarëve ose punonjësve të tij ose nga keqfunksionimi i sistemit ndërkombëtar të regjistrimit, me përjashtim të rastit të parashikuar nga neni 28 i Konventës, por që nuk përfshin humbjen ose dëmin që rezulton nga mungesa e aksesit në Zyrën Ndërkombëtare të Regjistrimit si rezultat i masave që përmenden në seksionin 3.4 të këtyre rregulloreve.

14.2 Çdo pretendim kundër regjistruesit sipas nenit 28 (1) të Konventës:

a) do të bëhet me shkrim brenda periudhës kohore që aplikohet sipas ligjeve të shtetit ku ndodhet Zyra Ndërkombëtare e Regjistrimit;

b) do t'u nënshtrohet konsultimeve midis pretenduesit dhe regjistruesit; dhe

c) nëse nuk zgjidhet me anë të këtyre konsultimeve, mund të ndiqet nga pretenduesi në përputhje me nenin 44 të Konventës.

14.3 Procedurat e Zyrës Ndërkombëtare të Regjistrimit do të parashikojnë detaje që lidhen me procedurën e parashikuar nga seksioni 14.2.

14.4 Shuma e siguracionit ose garancisë financiare të kërkuar sipas nenit 28 (4) të Konventës dhe nenit XX (5) të protokollit do të përcaktohet dhe mund të rishikohet nga autoriteti mbikëqyrës.

### SEKSIONI 15 PROCEDURAT E ZYRËS NDËRKOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

15.1 Procedurat e Zyrës Ndërkombëtare të Regjistrimit që trajtojnë çështjet e kërkuara nga këto rregullore ose që lidhen në një mënyrë tjetër me operacionet teknike dhe proceset administrative të Zyrës Ndërkombëtare të Regjistrimit, do të përcaktohen nga autoriteti mbikëqyrës.

15.2 Pa kufizuar përmbajtjen e tyre, Procedurat e Regjistrimit Ndërkombëtar do të parashikojnë proceset teknike dhe administrative:

a) për të kryer, ndryshuar dhe çregjistruar regjistrimet dhe për të bërë dhe marrë kopje të kërkimeve; dhe

b) për të marrë miratimet dhe autorizimet e kërkuara për të hyrë në Zyrën Ndërkombëtare të Regjistrimit.

## SEKSIONI 16 PUBLIKIMI

16.1 Versioni origjinal i këtyre rregulloreve dhe Procedurave Ndërkombëtare të Regjistrimit do të publikohet në një publikim zyrtar të autoritetit mbikëqyrës.

16.2 Regjistruesi do të bëjë një version elektronik të teksteve origjinale që përmenden në seksionin 16.1 siç mund të ndryshohen sipas parashikimit të seksionit 17, dhe ta vërë në dispozicion të publikut pa pagesë.

## SEKSIONI 17 AMENDAMENTET

17.1 Kërkesat për amendamente të këtyre rregulloreve ose Procedurave Ndërkombëtare të Regjistrimit mund të paraqiten nga ana e regjistruerit tek autoriteti mbikëqyrës, i cili do t'i shqyrtojë këto amendamente.

17.2 Versioni origjinal i çdo amendamenti të këtyre rregulloreve ose Procedurave Ndërkombëtare të Regjistrimit të miratuara nga autoriteti mbikëqyrës do të publikohet në një publikim zyrtar të autoritetit mbikëqyrës.

## SEKSIONI 18 DATAT E HYRJES NË FUQI

Rregulloret aktuale dhe Procedurat fillestare Ndërkombëtare të Regjistrimit do të hyjnë në fuqi në datën kur të hyjë në fuqi protokollin. Çdo amendament i këtyre rregulloreve ose Procedurave Ndërkombëtare të Regjistrimit do të hyjë në fuqi një muaj kalendarik pas datës së publikimit të tyre, përveçse kur përcaktohet ndryshe nga ana e autoritetit mbikëqyrës.

## PROCEDURAT

### SEKSIONI 1 AUTORITETET (SEKSIONI 15 I RREGULLOREVE).

Këto "Procedura" nxirren nga ana e Autoritetit Mbikëqyrës të Regjistrimit Ndërkombëtar sipas Konventës për interesat ndërkombëtare në pajisjet e lëvizshme, të nënshkruar në Kejp Taun më 16 nëntor 2001 (Konventa), protokollin i Konventës për interesat ndërkombëtare në pajisjet e lëvizshme për çështje specifike për pajisjet e avionit, nënshkruar në Kejp Taun më 16 nëntor 2001 (protokollin) dhe rregulloret për regjistrimin ndërkombëtar (rregulloret). Ato trajtojnë çështje administrative të kërkuara nga rregulloret si kushte për të përdorur Regjistrimin Ndërkombëtar ose që lidhen në një mënyrë tjetër me operacionin teknik dhe proceset administrative të regjistrimit ndërkombëtar.

### SEKSIONI 2 PËRKUFIZIME

Termet e përkufizuar në Konventë, protokoll dhe rregullore do të kenë të njëjtin kuptim në këto Procedura.

Veç kësaj, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e parashtruar më poshtë:

a) "Miratim" do të thotë:

i) ose një miratim elektronik nga ana e regjistruarit të një entit si ent përdorues i regjistrimit dhe/ose të një individi si administrator i atij përdoruesi të regjistrimit, në përputhje me seksionin 10 më poshtë; ose

ii) një miratim elektronik nga ana e administratorit të një individi si ent përdorues i regjistrimit dhe/ose të një individi si administrator i atij përdoruesi të regjistrimit, në përputhje me seksionin 11 më poshtë dhe "miratoj" dhe "i miratuar" do të kuptohet si më sipër.

b) "Konfirmim" do të thotë një konfirmim elektronik që jepet në përputhje me seksionin 6 të rregulloreve, i lëshuar automatikisht nga ana e regjistruarit kur një regjistrim, ndryshim ose anulim është i kërkuar.

c) "CPS" do të thotë deklarata e praktikës së certifikimit të regjistruarit, siç shfaqet në faqen e internetit.

d) "Certifikatë dixhitale" do të thotë një certifikatë dixhitale për përdorim në komunikimet me regjistrimin ndërkombëtar, e lëshuar për një administrator ose një përdorues tjetër të regjistrimit nga ana e regjistruarit në përputhje me këto procedura dhe CPS.

e) "Pëlqim përfundimtar" do të thotë një pëlqim elektronik i palës së fundit nga ato të emërtuara, pëlqimi i së cilës kërkohet sipas nenit 20 të Konventës në lidhje me një regjistrim, ndryshim ose anulim.

f) "Çelës privat" do të thotë çelësi privat që shoqërohet me një certifikatë dixhitale.

g) "Faqe interneti" do të thotë faqe interneti që jep ndërfaqen publike të Regjistrimit Ndërkombëtar dhe përmbajtjen e shoqëruar që jepet nga Regjistruari sipas lokalizuesit uniform të burimeve (URL):

<http://www.internationalregistry.aero>

### SEKSIONI 3

#### FUNKSIONET E REGJISTRUESIT (SEKSIONI 3 I RREGULLOREVE)

Regjistruari do të operojë regjistrimin ndërkombëtar dhe do të kryejë funksionet e caktuara nga ana e Konventës, protokollit dhe rregulloreve.

### SEKSIONI 4

#### FUNKSIONET E ENTIT PËRDORUES TË REGJISTRIMIT (SEKSIONI 4 I RREGULLOREVE)

Për qëllimin e përdorimit të regjistrimit ndërkombëtar, funksionet e mëposhtme futen në objektin e përgjegjësisë së secilit ent përdorues regjistrimi:

a) përzgjedhja e duhur dhe caktimi i administratorit të tij;

b) çdo veprim i administratorit të tij, duke përfshirë ndonjë administrator veprues, dhe përdoruesit e tij të regjistrimit që merren në lidhje me regjistrimin, të cilët do të konsiderohen se janë autorizuar siç duhet nga ana e entit përdorues të regjistrimit;

c) saktësia e të dhënave të transmetuara në regjistrimin ndërkombëtar në emrin e tij;

d) kërkimi nëpërmjet "kontaktit mbështetës" që përmendet në seksionin 5.12 më poshtë, që regjistruarit të revokojnë miratimin e administratorit që vepron në emër të entit përdorues të regjistrimit nëse administratori pushon së qeni i punësuar nga ana e entit përdorues të regjistrimit ose pushon së qeni i autorizuar të veprojë në emër të tij në një mënyrë tjetër;

e) t'u përmbahet termave dhe kushteve të aplikueshme që vendosen herë pas here për të rregulluar përdorimin e regjistrimit ndërkombëtar. Termat dhe kushtet e aplikueshme mund

të gjenden në faqen e internetit.

## SEKSIONI 5 FUNKSIONET E ADMINISTRATORIT TË NJË ENTI PËRDORUES TË REGJISTRIMIT (SEKSIONI 4 I RREGULLOREVE)

5.1 Një administrator që mund të jetë punonjës i një enti përdorues të regjistrimit, por që nuk është e nevojshme të jetë, do të emërohet rregullisht nga secili ent përdorues i regjistrimit, me autoritetin për të vepruar në emër të tij për qëllimet e regjistrimit ndërkombëtar dhe ky autoritet do të përfaqësohet gjatë procesit të miratimit.

5.2 Një administrator duhet të ketë kualifikime të duhura formale profesionale në përputhje me kërkesat e funksioneve të administratorëve.

5.3 Secili ent përdorues i regjistrimit mund të ketë vetëm një administrator në një kohë të caktuar.

5.4 Administratori i një enti përdorues transaksioni, i cili është miratuar nga regjistruesi, autorizohet automatikisht të kryejë, ndryshojë, çregjistrojë ose të japë pëlqimin për regjistrimet në të cilat ai ent është një palë e emërtuar.

5.5 Një administrator:

a) do të mbajë të sigurt fjalëkalimin e tij/të saj dhe certifikatën dixhitale; dhe

b) nuk do të transferojë certifikatën dixhitale të tij/të saj nga kompjuteri në të cilin është instaluar fillimisht me përjashtim të një kompjuteri zëvendësues nën kontrollin e tij/të saj, rast në të cilin ai/ajo do të aplikojë fillimisht te regjistruesi për atë qëllim.

5.6 Kur administratori i delegon fuqitë e tij kompetencat e tij/të saj në mënyrë elektronike te një administrator veprues në përputhje me seksionin 4.1 të rregulloreve, ai administrator veprues do të konsiderohet se është administratori për qëllimet e këtyre procedurave.

5.7 Kur administratori miraton në mënyrë elektronike një përdorues të regjistrimit që të veprojë në emër të një enti përdorues të regjistrimit në përputhje me seksionin 4.2 të rregulloreve, regjistruesi do t'i dërgojë një e-mail atij përdoruesi të regjistrimit që përmban një lidhje me një certifikatë dixhitale në përputhje me këto procedura.

5.8 Një administrator, nëpërmjet faqes së interneti:

a) do të përditësojë adresën e e-mail-it dhe detajet e tjera të administratorit dhe të çdo përdoruesi të regjistrimit që përfaqëson këtë ent përdorues të regjistrimit që mbahet nga regjistrimi ndërkombëtar;

b) do të revokojë menjëherë miratimin e përdoruesit të regjistrimit që përfaqëson këtë ent përdorues të regjistrimit në rastin kur ky përdorues i regjistrimit ndërpret punësimin ose pushon së pasuri lidhje në një mënyrë tjetër me këtë ent përdorues të regjistrimit;

c) do të revokojë autorizimin e përdoruesit të regjistrimit që përfaqëson këtë ent përdorues të regjistrimit në rastin kur ky përdorues regjistrimi nuk është më i autorizuar për të kryer, ndryshuar, çregjistruar ose për të dhënë pëlqimin për një ose më shumë regjistrime në të cilat ai ent është një palë e emërtuar.

5.9 Në rastin kur një administrator do të ndërpresë marrëdhëniet e punës me entin përdorues të regjistrimit në emër të të cilit ai/ajo është i/e autorizuar të veprojë ose nëse ka ndonjë ndryshim të administratorit, administratori do të njoftojë për këtë në kohën e duhur regjistruesin në formë elektronike. Nëse enti përdorues i zyrës së regjistrimit dëshiron të emërojë një administrator zëvendësues, ky emërim do t'i nënshtrohet pagesës së regjistrimit që aplikohet për një administrator të ri.

5.10 Administratori i një enti përdorues të regjistrimit do të ketë autoritetin nëpërmjet faqes së internetit të blloktojë dhe/ose të çaktivizojë llogarinë e përdoruesit të një përdoruesi të regjistrimit që përfaqëson entin e tij/të saj përdorues të regjistrimit. Është përgjegjësia e

administratorit ta ndërmarrë këtë veprim menjëherë në rastin e një shkeljeje të sigurisë që lidhet me një llogari përdoruesi të këtij përdoruesi të regjistrimit, për të cilën ai/ajo ka njohuri praktike, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar me cenimin e çelësit privat të këtij përdoruesi të regjistrimit.

5.11 Administratori i një enti përdorues të regjistrimit do ta njoftojë regjistruenin për ndonjë shkelje të tillë të sigurisë (për shembull një shkelje që cenon çelësin privat), për të cilin ai/ajo ka njohuri praktike, që pritet të rezultojnë në regjistrime të paautorizuara. Nëse shkelja e sigurisë lidhet me një llogari përdoruesi të regjistrimit, administratori mund ta bllokojë dhe/ose ta ç'aktivizojë llogarinë.

5.12 Nëse llogaria e një administratori i nënshtrohet shkeljes së një sigurie që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të çojë në akses të paautorizuar dhe përdorim të regjistrimit ndërkombëtar, regjistrueni dhe enti përdorues i regjistrimit do të bashkëpunojnë në mënyrë që të marrin veprimet rregulluese sa më shpejt në këto rrethana. Një ent përdorues i regjistrimit do të emërojë një "kontakt mbështetës" për këto qëllime.

5.13 Me njoftimin për shkeljen e sigurisë, regjistrueni mund të bllokojë dhe/ose të çaktivizojë secilin llogari përdoruesi.

5.14 Regjistrueni mund të bëjë kontrolle të tilla të arsyeshme të identitetit të një administratori të propozuar, siç e çmon të nevojshme regjistrueni në lidhje me atë person që merr përsipër këtë funksion. Regjistrueni mund të bëjë kontrolle të tilla të ngjashme për një përdorues regjistrimi, aty ku konsiderohet e domosdoshme nga ana e regjistruenit.

5.15 Secili administrator mund të miratojë në mënyrë elektronike përdorues të tjerë të regjistrimit që të veprojnë në emër të entit përdorues të regjistrimit, që ai administrator (kur autorizohet ta bëjë këtë) dhe mund të miratojë nxjerrjen e një certifikate dixhitale për secilin nga këta përdorues regjistrimi.

5.16 Administratori ka përgjegjësinë e vetme për përzgjedhjen e përdoruesve të regjistrimit të entit përdorues të regjistrimit të tij/të saj dhe për sigurimin që vetëm individët, të cilët janë të autorizuar në mënyrë të rregullt për të vepruar në emër të entit përdorues të regjistrimit të tij/të saj të emërohen herë pas here si përdorues të regjistrimit.

## SEKSIONI 6 FUNKSIONET E PËRDORUESIT TË REGJISTRIMIT (SEKSIONI 4 I RREGULLOREVE)

6.1 Asnjë individ, përveç një administratori, nuk mund të kryejë, ndryshojë, çregjistrojë ose japë pëlqimin për regjistrimet në regjistrimin ndërkombëtar derisa ai/ajo të jetë miratuar si përdorues regjistrimi nga ana e administratorit të entit përdorues të regjistrimit që ky person përfaqëson.

6.2 Asnjë përdorues i regjistrimit nuk mund t'i transmetojë informacion Zyrës së Regjistrimit Ndërkombëtar për të kryer, ndryshuar ose ç'regjistruar një regjistrim në lidhje me një objekt avioni, nëse ky përdorues regjistrimi nuk ka marrë fillimisht autorizimin për ta kryer këtë në lidhje me këtë objekt avioni ose:

a) në rastin e një përdoruesi transaksionesh, nga administratori i entit përdorues të transaksionit që e përfaqëson atë, ose

b) në rastin e një përdoruesi profesionist, nga administratori i entit përdorues të transaksionit që është klient i këtij përdoruesi profesionist.

6.3 Çdo përdorues regjistrimi:

a) do ta mbajë të sigurt fjalëkalimin dhe certifikatën dixhitale të tij/të saj;  
dhe

b) nuk do të transferojë certifikatën e tij/të saj nga kompjuteri në të cilin është instaluar fillimisht, me përjashtim të kompjuterit zëvendësues që është në kontrollin e tij/të

saj, rast në të cilin ai/ajo do të aplikojë fillimisht tek regjistruesi për këtë qëllim.

6.4 Çdo përdorues regjistrimi do ta njoftojë administratorin e tij/të saj përkatës për ndonjë shkelje të sigurisë, për të cilin ai/ajo është në dijeni, që pritet të çojë në regjistrime të paautorizuara duke përfshirë një përdorim të paautorizuar, publikim ose cenim të fjalëkalimeve ose të çelësave të tij / të saj private.

6.5 Çdo përdorues i regjistrimit pranon se administratori i tij/i saj përkatës mund t'i bëjë këto kontrolle të identitetit ashtu siç regjistruesi e çmon të nevojshme në lidhje me aksesin e këtij përdoruesi të regjistrimit në regjistrimin ndërkombëtar.

## SEKSIONI 7 AKSESI NË ZYRËN NDËRKOMBËTARE TË REGJISTRIMIT (SEKSIONI 4 I RREGULLOREVE)

7.1 Regjistrimi ndërkombëtar mund të vihet në dispozicion nëpërmjet internetit publik në adresën URL:

<http://www.internationalregistry.aero>.

7.2 Regjistrimi ndërkombëtar fillimisht do të jetë i disponueshëm vetëm në gjuhën angleze. Është parashikuar që edhe gjuhë të tjera do të shtohen kur të disponohen mjetet e nevojshme financiare duke marrë parasysh implikimet për këtë, si dhe avantazhet për përdoruesit.

7.3 Për t'u futur në regjistrimin ndërkombëtar, një administrator, përdorues regjistrimi ose një person kërkues kërkon akses nëpërmjet internetit me një shfletues të përputhshëm, siç specifikohet në faqen e internetit. Secili prej këtyre personave do të bëjë rregullimet e tij/të saj për:

- a) aksesin në internet; dhe
- b) kontraktimin me kryerjen e pagesave të një pale të tretë siguroese të shërbimit të internetit.

Regjistrimi ndërkombëtar shtrihet vetëm në pikën e aksesit në internetin që ndodhet në vendndodhjen e regjistruesit pritës.

7.4 Regjistrimi ndërkombëtar do të jetë i disponueshëm 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, me përjashtim të rasteve të mirëmbajtjes së kryer jashtë periudhave të ngarkesës maksimale, ose problemeve teknike ose të sigurisë. Lajmërimi paraprak i ndonjë ndërprerjeje për akses dhe rifillimi i pritshëm i shërbimeve deri në shkallën maksimale të mundshme nga ana praktike do të jepen nëpërmjet faqes së internetit.

7.5 Aksesin në regjistrimin ndërkombëtar kushtëzohet nga:

- a) në rastin e administratorit dhe të përdoruesit të regjistrimit, që kanë një certifikatë të vlefshme dixhitale dhe që përputhet me pjesën e aplikueshme të CPS që lidhet me përdorimin e tij/të saj dhe, aty ku kërkohet, duke futur fjalëkalimin e saktë;
- b) duke ndjekur hapat dhe procedurat që jepen në faqen e internetit, duke përfshirë pranimin e termave dhe kushteve të faqes së internetit dhe CPS dhe duke iu përmbajtur atyre;
- c) duke paguar paraprakisht pagesat që vendos autoriteti mbikëqyrës dhe të publikuara në faqen e internetit; dhe
- d) duke iu përmbajtur këtyre Procedurave.

7.6 Nëse një fjalëkalim i administratorit ose përdoruesit të regjistrimit futet në mënyrë të gabuar, atij personi do t'i jepet rasti për ta rifitur fjalëkalimin ose për ta ndërprerë veprimin. Nëse bëhen tri përpjekje të dështuara për të futur fjalëkalimin e saktë, llogaria e përdoruesit korrespondues do të bllokohet deri sa të bëhet kontakti me zyrën e ndihmës dhe deri sa të korrigjohet çështja që ka çuar në këtë dështim.



SEKSIONI 8  
PIKAT E HYRJES  
(SEKSIONI 12 I RREGULLOREVE)

8.1 Regjistruesi do të bëjë rregullime të aplikueshme për transferimin elektronik të informacionit të regjistrimit prej ose të autorizuar nga pikat e hyrjes të regjistrimit ndërkombëtar të emëruar sipas nenit XIX (1) të protokollit dhe seksionit 12 të rregulloreve dhe pas konsultimeve me çdo pikë hyrjeje të caktuar, do të specifikojë rregullimet aplikueshme në atë pikë hyrjeje. Rregullimet e aplikueshme, të caktuara për të rritur përdorimin efikas të regjistrimit ndërkombëtar nga ana e pikave të hyrjes, do të publikohen në faqen e internetit.

8.2 Të gjithë përdoruesit e regjistrimit që bëjnë regjistrime nëpërmjet pikës së hyrjes së caktuar ose pikave të hyrjes sipas nenit XIX (1) të protokollit do t'i përmbahen rregullimeve që përmenden në seksionin pararendës 8.1.

SEKSIONI 9  
ZYRA E NDIHMËS DHE MBËSHTETJA TEKNIKE  
(SEKSIONI 3.5 I RREGULLOREVE)

9.1 Për t'u futur në funksionin mbështetës teknik të regjistrimeve ndërkombëtare, një administrator, një përdorues regjistrimi ose një person kërkues mund të çojë e-mail ose të telefonojë zyrën e ndihmës, siç specifikohet në faqen e internetit. Rekomandohet që faqet e "ndihmës" të internetit dhe e-mail-i të përdoren kur është e mundur. Ndonjë person që komunikon me zyrën e ndihmës dhe të e-mail-it i kërkohet që:

- a) të specifikojë natyrën e problemit ose të çështjes;
- b) të japë emrin e tij/të saj të plotë dhe emrin e shoqërisë;
- c) të identifikojë cili tip i përdoruesit ai ose ajo është (për shembull administrator, përdorues regjistrimi ose person kërkues); dhe
- d) të japë një numër telefoni të kontaktit kryesor.

Regjistruesi, deri në shkallën që përputhet me të drejtën e aplikueshme të jetës private (privatësisë), mund të verifikojë identitetin e të gjithë telefonuesve dhe të regjistrojë të gjitha telefonatat në zyrën e ndihmës.

9.2 Termat e seksionit 3.4 të rregulloreve dhe seksionit 7.4 të këtyre Procedurave do të aplikohen për:

- a) orët e operacionit të zyrës së ndihmës dhe përjashtimeve të saj; dhe
- b) të njoftojë ndërprerjen dhe fillimin e aksesit në zyrën e ndihmës dhe shërbimeve të saj.

9.3 Gjuha fillestare e punës së zyrës do të jetë anglishtja, frëngjishtja dhe spanjishtja. Parashikohet që gjuhë të tjera të shtohen kur të jenë të disponueshme mjetet financiare të nevojshme, duke marrë parasysh implikimet për të dhe avantazhet për përdoruesit.

9.4 Orët e përgjigjes së zyrës së ndihmës do të varen nga kërkesat dhe nuk mund të garantohen për këtë arsye.

9.5 Zyra e ndihmës është vetëm për mbështetje teknike dhe nuk mund të japë mbështetje për çështje të tjera, duke përfshirë çështjet ligjore. Zyra e ndihmës nuk mund t'u përgjigjet pyetjeve në lidhje me:

- a) sistemin e kompjuterëve ose të rrjetit;
- b) politikat e sigurisë së sistemit;
- c) aksesit të internetit, duke përfshirë lidhjen e tij dhe performancën, ose
- d) shfletuesin.

SEKSIONI 10  
REGJISTRIMI DHE MIRATIMI  
ENTI PËRDORUES I REGJISTRIMIT DHE ADMINISTRATORI  
(SEKSIONI 4 I RREGULLOREVE)

10.1 Në lidhje me miratimet sipas seksionit 4.1 të rregulloreve, administratori i propozuar i një enti përdorues të regjistruar të propozuar do të plotësojë dhe do të paraqesë në mënyrë elektronike te regjistruesi nëpërmjet faqes së internetit formën për miratim të:

- a) një enti përdorues të regjistrimit;
- b) një administratori të atij enti.

Informacioni, i caktuar si i detyrueshëm në formular, do të jepet. Informacioni, i caktuar në formular sipas dëshirës, mund të jepet. Emrat e organizatave dhe të personave duhet të jenë emrat e tyre të saktë ligjorë. Në raste përjashtimore (p.sh. aty ku hapësira në formular është e pamjaftueshme), miratimi i regjistruesit për përdorimin e një emri tjetër përveç emrit të saktë ligjor duhet të kërkohet me anë të e-mail-it. Një ent përdorues i regjistruar i propozuar duhet të paraqesë gjithashtu në formë elektronike tek regjistruesi, me nënshkrim të saktë, konfirmimin që një administrator i propozuar ka të drejtën të veprojë në atë cilësi. Me kërkesën specifike të regjistruesit, ky konfirmim do të jepet i shtypur në fletë me kokën e entit, me firmën e saktë. Të gjitha aplikimet për miratim do të përfshijnë pranimin e këtyre procedurave dhe të termave dhe të kushteve të internetit që rregullojnë veprimin e regjistrimit ndërkombëtar.

10.2 Të gjitha aplikimet për miratim duhet të shoqërohen me pagesë të plotë (me kartë krediti ose debiti) të pagesës së duhur të pakthyeshme, së bashku me tatimin e vlerës së shtuar (TVSH) nëse kërkohet nga ligji. Administratori i propozuar do të paraqitet me një përmbledhje të shumës (në dollarë amerikanë) që duhet të paguhet pa vonesë dhe do të kryhet regjistrimi i detajeve të kartës së kreditit ose debitit.

Kur të jenë paraqitur dhe të kenë hyrë në fuqi detajet e kartës, pagesa do të merret nga llogaria përkatëse dhe atij personi do t'i jepet një konfirmim dhe opsioni për të ruajtur një kopje dixhitale të faturës.

10.3 Të gjitha aplikimet për miratime do të pranohen në adresën e postës elektronike të dhënë në formularin e aplikimit të paraqitur.

10.4 Administratori i propozuar do t'u përgjigjet menjëherë kërkesave për informacion shtesë nga ana e regjistruesit në lidhje me procesin e miratimit. Këto kërkesa, të bëra vetëm me diskrecionin e regjistruesit, do të jenë në përputhje me ligjet e aplikueshme për jetën private (privatësinë).

10.5 Nëse është i kënaqur me informacionin e dhënë, regjistruesi do t'i lëshojë administratorit të propozuar në formë elektronike, miratimin e regjistruesit dhe një njoftim të URL në të cilën administratori mund të futet për certifikatën e tij/të saj dixhitale, së bashku me udhëzimet e duhura për përdorimin e saj.

10.6 Regjistruesi do të lëshojë miratimin e tij (nëse jepet) sapo të jetë praktike në mënyrë të arsyeshme dhe do të përpiqet të plotësojë procesin e miratimit brenda 48 orësh nga marrja e aplikimit.

10.7 Kur regjistruesi të ketë lëshuar miratimin e tij, administratori do të testojë aftësinë e tij/të saj për t'u futur në faqen e internetit.

10.8 Regjistruesi nuk do të miratojë ent përdoruesi të regjistrimit ose një administrator kur regjistruesi beson se kërkesat e seksionit 4.1 të rregulloreve nuk janë plotësuar. Në këtë rast, regjistruesi, nëse kërkohet me shkrim:

- a) do të specifikojë me shkrim, nëpërmjet e-mail-it arsyet përse këto kërkesa nuk janë plotësuar; dhe
- b) do t'i japë aplikantit rastin e arsyeshëm që të ndërmarrë veprime korrigjuese.

Nëse nuk korrigjohen, me diskrecionin e vetëm të regjistruarit, aplikimi do të refuzohet. Refuzimi i një aplikimi nuk do ta ndalojë një aplikant që të bëjë një aplikim pasues për miratim, me kushtin që kërkesat e këtyre procedurave të jenë plotësisht në përputhje me to, dhe të kryhet pagesa e duhur së bashku me TVSH (nëse aplikohet).

10.9 Pagesa për lëshimin e certifikatës dixhitale zëvendësuese do të paguhet nga enti përdorues i regjistrimit. Një person që kërkon një certifikatë dixhitale zëvendësuese do të aplikojë tek regjistruari dhe do të ndjekë udhëzimet e specifikuar në faqen e internetit.

10.10 Regjistruari mund të revokojë miratimin e një enti përdorues të regjistrimit dhe/ose një administrator në çdo kohë kur, sipas pikëpamjes së tij, ka një rrezik material për regjistrime mashtruese ose keqpërdorime të tjera. Në këtë rast, regjistruari dhe enti përdorues i regjistrimit do të marrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të bashkëpunuar për të kryer me shpejtësi veprimet korrigjuese që duhen sipas rrethanave;

Kontakti i mbështetjes i caktuar sipas seksionit 5.12 mund të përdoret siç kërkohet. Regjistruari mund të bllokojë dhe/ose të çaktivizojë ndonjë llogari përdoruesi të entit përdorues të regjistrimit në fjalë.

## SEKSIONI 11 REGJISTRIMI DHE MIRATIMI-PËRDORUESI I REGJISTRIMIT (SEKSIONI 4 I RREGULLOREVE)

11.1 Në lidhje me miratimin e përdoruesve të regjistrimit sipas seksionit 4.2 të rregulloreve, një përdorues i regjistrimit të propozuar që kërkon të veprojë në emër të një enti përdorues regjistrimi të miratuar do të aplikojë nëpërmjet faqes së internetit, duke kërkuar miratimin elektronik nga ana e administratorit të atij enti.

11.2. Një administrator ka të drejtën e vetme të miratojë një ose më tepër përdorues të regjistrimit të punësuar nga ana e entit përdorues të regjistrimit për të vepruar në emër të tij/të saj. Nëse administratori zgjedh që të miratojë këta përdorues të regjistrimit, administratori do ta ndërmarrë atë veprim nëpërmjet faqes së "përdoruesit të regjistrimit të miratuar të regjistrimit" në faqen e internetit, duke specifikuar periudhën e vlefshmërisë së aksesit të përdoruesit të regjistrimit të propozuar në zyrën e regjistrimit ndërkombëtar dhe duke e udhëzuar atë që bëjë pagesën shoqëruese.

11.3 Me marrjen e miratimit të administratorit të tij/ të saj dhe duke ndjekur testimin e suksesshëm të aftësisë së tij/të saj për t'u futur në faqen e internetit, një përdoruesi regjistrimi do t'i lëshohet një certifikatë dixhitale nga ana e administratorit nëpërmjet një e-mail-i që përmban një lidhje në faqen e internetit. Përdoruesi i regjistrimit duhet të shkarkojë atëherë në faqen e internetit certifikatën dixhitale që i jep atij/asaj çelësin privat.

## SEKSIONI 12 KRYERJA, NDRYSHIMI DHE ANULIMI I REGJISTRIMEVE (SEKSIONET 5 DHE 6 TË RREGULLOREVE)

12.1 Për të kryer, ndryshuar ose anuluar një regjistrim, një person regjistruar:  
a) do të ndjekë procesin përkatës dhe udhëzimet e specifikuar në faqen e internetit;  
dhe

b) do të plotësojë formularët elektronikë që përmban faqja e internetit me informacionin përkatës, kërkuar nga seksioni 5 i rregulloreve.

Informacioni i regjistrimit i dhënë në formë elektronike në faqen e internetit do të përdoret nga personi regjistruar, siç kërkohet nga seksioni 5 i rregulloreve.

Deri në shkallën që ky informacion nuk jepet, informacioni i regjistrimit do të futet nga personi regjistruar duke ndjekur udhëzimet e specifikuar në faqen e internetit.

12.2 Secila palë e emërtuar, e ndryshme nga pala regjistruese, që i kërkohet të japë pëlqimin sipas nenit 20 të Konventës, në mënyrë që kryerja e një regjistrimi, ndryshimi ose anulimi të hyjë në fuqi, duhet të kërkohet në formë elektronike që të jepet pëlqimi për to, në përputhje me nenin 18 (1) (a) të Konventës, para se ai regjistrim, ndryshim ose anulim të bëhet i kërkueshëm. Kur një person regjistrues e ka bërë regjistrimin , ndryshimin ose ka anuluar informacionin në faqen e internetit dhe e ka nënshkruar atë në mënyrë dixhitale, çdo palë e emërtuar, identifikuar në regjistrim:

a) do të njoftohet për këtë nëpërmjet postës elektronike, dhe

b) do t'i jepet mundësia që të japë pëlqimin për to nëpërmjet faqes së internetit, për një periudhë prej 36 orësh.

Në rastin kur kjo palë e emërtuar nuk arrin që të japë pëlqimin e saj brenda 36 orësh, regjistrimi, ndryshimi ose anulimi do të ndërpritet në mënyrë automatike.

12.3 Me marrjen e pëlqimit përfundimtar, regjistruesi do t'u lëshojë automatikisht një kopje për këtë të gjitha palëve të emërtuara në regjistrime të tjera që lidhen me të njëjtin objekt avioni dhe të gjitha palëve që kanë të drejtën e marrjes së konfirmimit për të, sipas seksionit 6 të rregulloreve, me kushtin që të jenë dhënë më përpara adresat e sakta të e-mail-it të këtyre palëve.

12.4 Një administrator, me diskrecionin e tij/të saj të vetëm, mund të autorizojë një ose disa nga përdoruesit e miratuar të regjistrimit ose përdoruesit profesionalë që të kryejnë, të ndryshojnë ose të çregjistrojnë një regjistrim. Autorizimi mund të mbulojë një ose disa objekte avioni. Disa përdorues mund të autorizohen që të punojnë në të njëjtin objekt ose objekte avioni, por jo në të njëjtën kohë gjatë të njëjtit seksion regjistrimi. Një administrator mund të revokojë në çdo kohë një autorizim që ai/ajo ka dhënë dhe mund të japë autorizime të mëtejshme për përdoruesit kualifikues të regjistrimit.

12.5 Me marrjen e një konfirmimi, çdo palë e emërtuar që dëshiron të sigurohet se rubrika përkatëse është bërë siç duhet, mund të ndërmarrë një kërkim prioritar.

12.6 Korrigjimi i ndonjë gabimi apo pasaktësie në një regjistrim, pasi të jetë bërë i kërkueshëm, mund të kryhet nëpërmjet një regjistrimi të amenduar.

12.7 Të iniciuara, por jo të plotësuara, regjistrimet, ndryshimet ose çregjistrimet nuk do të shfaqen në ndonjë rezultat kërkimi.

## SEKSIONI 13

### KRYERJA E KËRKIMEVE DHE MARRJA E REZULTATEVE TË KËRKIMIT (SEKSIONI 7 I RREGULLOREVE)

13.1 Çdo person, pasi kryen pagesën e kërkuar, mund të kërkojë në regjistrimin ndërkombëtar, dhe ai person kërkues:

a) do të ndjekë procesin përkatës dhe udhëzimet e specifikuara në faqen e internetit; dhe

b) do të plotësojë formularët elektronikë që ndodhen në faqen e internetit, me informacionin përkatës të kërkuar nga seksioni 7 i rregulloreve.

13.2 Objekti i një kërkimi informativ është që t'i japë personit kërkues informacion të mjaftueshëm për të kryer një kërkim prioritar.

13.3 Një renditje e kërkimit informativ do të bëhet e disponueshme në formë elektronike për personin që merr përsipër kërkimin. Për të shmangur dyshimin, një kërkim informativ nuk do të gjenerojë një certifikatë kërkimi. Regjistruesi nuk do të përgjigjet në lidhje me përmbajtjen e një renditjeje informative të kërkimit.

13.4 Gjatë bërjes së kërkimit prioritar ose të kërkimit të shtetit kontraktues, personi kërkues do të deklarojë emrin e personit ose personave që përfitojnë nga pëlqimi. Emri i këtij personi ose këtyre personave do të shfaqet në certifikatën e kërkimit prioritar ose në

certifikatën e kërimit të shtetit kontraktues, sipas rastit. Përfituesit mund të jenë:

a) palët që hyjnë, planifikojnë ose që i përmbahen transaksioneve tregtare duke futur një palë të emërtuar ose një objekt avioni; ose

b) palët që japin konsulencë ligjore ose këshillime të tjera profesionale ose që sigurojnë, palët e specifikuar në klauzolën “a” pararendëse direkt më sipër.

13.5 Certifikatat e kërimit prioritar dhe certifikatat e kërimit të shtetit kontraktues do të nënshkruajnë në mënyrë dixhitale nga regjistruesi dhe duhet të nënshkruhen në mënyrë që të jenë të vlefshme. Ato do të ruhen në mënyrë elektronike nga ana e regjistruesit. Një version elektronik i tij do të lëshohet dhe do të bëhet i disponueshëm për personin kërkuar. Një version i printuar i secilës prej këtyre certifikatave do të bëhet i disponueshëm me kryerjen e pagesës së kërkuar.

13.6 Pagesat për kërkimet e shtetit kontraktues të ndërmarra nga autoritete qeveritare nga shtete kontraktuese për qëllime zyrtare nuk do të bëhen.

Pagesat për kërkimet e tjera të kryera nga këto autoritete mund të mos kërkohen sipas rregullimeve të bëra me regjistruesin.

## SEKSIONI 14 ANKESAT OPERACIONALE (SEKSIONI 8 I RREGULLOREVE)

14.1 Në përputhje me seksionin 8 të rregulloreve, çdo person mund të paraqesë një ankesë operationale tek regjistruesi nëpërmjet "ankesave operationale" të faqes së internetit ose me anë të e-mail-it, siç specifikohet në faqen e internetit. Marrja e një ankese operationale do të pranohet menjëherë nga ana e regjistruesit.

14.2 Ankesat operationale do të përfshijnë një deklaratë me shkrim që përmban detajet e plota të fakteve të përmendura, të cilat çojnë tek ankesa.

14.3 Regjistruesi do t'i përgjigjet ankesës ose do të deklarojë pse nuk është në gjendje ta bëjë këtë brenda 15 ditësh kalendarike të marrjes së ankesës ose, nëse bëhet më vonë, pasi të merren të gjitha faktet e plota të deklaratës.

Regjistruesi do t'i transmetojë një kopje të përgjigjes së tij autoritetit mbikëqyrës.

14.4 Nëse, brenda 30 ditësh kalendarike nga bërja e ankesës, personi nuk konsideron që çështja është trajtuar ose po trajtohet në mënyrë të kënaqshme nga ana e regjistruesit, ai person mund të paraqesë ankesën tek autoriteti mbikëqyrës (me një kopje të regjistrimit) për shqyrtim të mëtejshëm. Paraqitja e ankesës tek autoriteti mbikëqyrës do të bëhet duke deklaruar faktet e plota të çështjes ose nëpërmjet e-mailit në adresën:

LEB@icao.int ose me anë të letrës ose faksit në adresën:

International Civil Aviation Organization  
Supervisory Authority of the International Registry  
c/o Legal Bureau  
999 University Street  
Montréal, Quebec  
Canada H3C 5H7

Fax: +1 514-954-8032.

14.5 Nëse autoriteti mbikëqyrës përcakton se ndryshimet në procedurat ose politikat e regjistrimit ndërkombëtar janë të përshtatshme, ai do të udhëzojë regjistruesin që t'i kryejë këto ndryshime.

SEKSIONI 15  
PRETENDIMET KUNDËR REGJISTRUESIT  
(SEKSIONI 14 I RREGULLOREVE)

15.1 Pretendimet mund të ngrihen kundër regjistruetit sipas nenit 28 të Konventës për humbjen e pësuar, siç përcaktohet nga seksioni 14 i rregulloreve.

Në përputhje me nenin 28 (2), regjistrueti nuk do të përgjigjet për pasaktësitë faktike të informacionit të regjistrimit të marrë nga regjistrueti ose të transmetuar nga regjistrueti në formën në të cilën e mori atë informacion, as për aktet apo rrethanat për të cilat regjistrueti dhe punonjësit e tij nuk përgjigjen dhe që dalin para marrjes së informacionit të regjistrimit në regjistrimin ndërkombëtar.

15.2 Të gjitha këto pretendime do t'i njoftohen me shkrim regjistruetit me postë dhe/ose me faks ose e-mail në adresën:

Aviareto Ltd.  
Suite 11  
Plaza 212  
Blanchardstown Corporate Park Phase 2  
Blanchardstown  
Dublin 15  
Republic of Ireland  
Fax: +353 (0)1 829 3508  
Email: registryofficials@aviareto.aero

dhe do të përfshijnë një deklaratë të plotë të fakteve që çojnë tek pretendimi sipas nenit 28 të Konventës. Kjo deklaratë do t'i jepet regjistruetit brenda tre muajsh nga informimi i personit për ekzistencën e pretendimit.

15.3 Të gjitha këto pretendime do t'i nënshtrohen një periudhe konsultimi, gjatë së cilës pretenduesi dhe regjistrueti do të përpqen në mirëbesim ta zgjidhin pretendimin. Periudha e konsultimit do të jetë tre muaj nga data kur regjistrueti merr njoftimin për pretendimin ose deklaratën e fakteve (nëse më vonë). Periudha tremujore mund të zgjatet me marrëdhënie reciproke të palëve.

15.4 Nëse pas periudhës së konsultimit pretendimi nuk është zgjidhur, palët inkurajohen që të angazhohen në ndërmjetësim, pajtim, arbitrazh apo në një proces tjetër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, por ankuesi, duke iu nënshtuar kërkesave procedurale të ligjit të aplikueshëm, mund të fillojë procedurat kundër regjistruetit në përputhje me nenin 28 dhe 44 të Konventës.

15.5 Asgjë në këto proceduara:

a) nuk do të veprojë për të zgjatur ndonjë periudhë kufizimi të aplikueshme sipas ligjit të aplikueshëm; ose

b) nuk do të cenojë të drejtën e një pale për të filluar procedurat, prej së cilës përndryshe do të skadonte një periudhë kufizimi.

SEKSIONI 16  
KONFIDENCIALITETI  
(SEKSIONI 9 I RREGULLOREVE)

Regjistrueti do ta mbajë konfidencial të gjithë informacionin e regjistrimit ndërkombëtar, me përjashtim të rasteve:

a) kur jepet në përgjigje të një kërkimi prioritar, një kërkimi të një shteti kontraktues ose kërkimi informativ, ose bëhet i disponueshëm në formë elektronike për t'u mundësuar

përdoruesve të regjistrimit që të kryejnë, ndryshojnë ose të anulojnë regjistrimet;

b) kur kërkohet sipas nenit 27 paragrafi 5 i Konventës ose kur i jepet autoritetit mbikëqyrës me kërkesën e këtij të fundit, ose

c) kur përdoret për qëllimet e statistikave të kërkuara nga seksioni 10 i Rregulloreve për Regjistrimin Ndërkombëtar.

## SEKSIONI 17 NJOFTIMET

Regjistruesi mund të njoftojë një administrator apo një ent përdorues të regjistrimit me anë të e-mail-it në adresën aktuale të e-mail-it, të dhënë prej atij personi ose për atë person për çfarëdo çështje që ndikon në regjistrimin ndërkombëtar. Me përjashtim të rastit kur merret një njoftim i padërguar i gjeneruar nga sistemi, çdo njoftim i tillë do të prezumohet që është marrë 24 orë pasi të jetë dërguar.

## SEKSIONI 18 PAGESAT (SEKSIONI 13 I RREGULLOREVE)

Të gjitha pagesat e aplikueshme do të kryhen paraprakisht. Tabela e pagesave aktuale paraqitet në shtojcën e procedurave aktuale dhe mund të rregullohet herë pas here nga autoriteti mbikëqyrës, siç parashikohet në Konventë dhe protokoll.

## SEKSIONI 19 PUBLIKIMI (SEKSIONI 16 I RREGULLOREVE)

19.1 Versioni origjinal i këtyre procedurave do të publikohet në një publikim zyrtar të autoritetit mbikëqyrës.

19.2 Regjistruesi do të bëjë versionin elektronik të këtyre procedurave siç mund të ndryshohet, të disponueshëm për publikun pa pagesë, duke e publikuar atë në faqen e internetit.

## SEKSIONI 20 AMENDAMENTET (SEKSIONI 17 I RREGULLOREVE)

20.1 Kërkesat për amendamentet e këtyre procedurave mund të paraqiten nga regjistruesi tek autoriteti mbikëqyrës, i cili do t'i shqyrtojë këto amendamente.

20.2 Versioni origjinal i çdo amendamenti të këtyre procedurave, të miratuar nga autoriteti mbikëqyrës, do të publikohet në një publikim zyrtar të autoritetit mbikëqyrës.

## SEKSIONI 21 DATAT E HYRJES NË FUQI (SEKSIONI 18 I RREGULLOREVE)

Këto procedura do të hyjnë në fuqi në datën kur hyn në fuqi protokollin. Çdo amendament i këtyre procedurave do të hyjë në fuqi një muaj kalendarik pas datës së publikimit të tyre, përveçse kur përcaktohet ndryshe nga ana e autoritetit mbikëqyrës.

SHTOJCË  
TABELA E PAGESAVE

1. PAGESAT PËR PËRDORIMIN E REGJISTRIT KOMBËTAR

Pagesa për krijimin e përdoruesit

1.1 Asnjë person nuk mund të regjistrohet në regjistrimin ndërkombëtar pa paguar një "pagesë për krijimin e përdoruesit". Do të ketë tri opsione të hapura për përdoruesin:

- a) abonim 5-vjeçar;
- b) abonim 1-vjeçar;
- c) abonim 5-vjeçar me 10 përdorues.

1.2 Për opsionin (c), personi që blen abonimin, do të emërohet si administratori i grupit të përdoruesve dhe do t'i jepet një kredit përdoruesi për të krijuar 9 përdoruesit e tjerë të veçantë në një ose disa seksione përdoruesi. Këta përdorues do të jenë të vlefshëm për 5 vjet duke iu nënshtruar zëvendësimit të përdoruesve të veçantë nëpërmjet administratorit.

1.3 Një përdorues mund të përfaqësojë si punonjësin e tij/të saj parësor dhe shoqëritë e kontrolluara nga punëdhënësi parësor (d.m.th. kur një shoqëri e veçantë kontrollohet nga një përdorues regjistrimi ekzistues, nuk duhet të kërkohen pagesat për krijimin e përdoruesit në mënyrë të veçantë).

1.4 Pagesat për krijimin e përdoruesit përcaktohen në tabelën 1. Këto pagesa përfshijnë dhënien e certifikatës së infrastrukturës së çelësit publik (PKI) që instalohet në stacionin e punës së përdoruesit. Në rast se kjo certifikatë humbet ose shkatërrohet, do të jepet një certifikatë e re me pagesën e një "pagese për certifikatën e humbur", siç parashikohet në tabelën 1.

Pagesa e regjistrimit

1.5 Një pagesë e vetme regjistrimi do të bëhet për të gjitha regjistrimet e kryera gjatë "sesionit të regjistrimit", të përkufizuara me kuptimin e një sesioni me regjistrimin ndërkombëtar, që lejon "të gjitha regjistrimet", të cilat lidhen me:

- a) një korpus avioni dhe të gjithë motorët që përdoren rregullisht në të (ose në ndonjë nënbashkësi e tij ose ndonjë motor i veçantë);ose
- b) një helikopter.

Për këtë qëllim, "të gjitha regjistrimet" nënkuptojnë të gjitha regjistrimet që pasqyrojnë transaksionet që lidhen me objektin ose me objektet e parashtruara në klauzolat (a) ose (b), të cilat kryhen në të njëjtën datë të hyrjes në fuqi, siç konfirmohet në formë elektronike nga palët regjistruese dhe miratuese, duke përfshirë ato që reflektojnë tipa të ndryshëm ose të shumëfishtë regjistrimesh të lejuara sipas Konventës dhe protokollit pa kufizim në numër (p.sh. një interes ndërkombëtar (marrëveshje lizingu/qiraje), një interes i dytë ndërkombëtar (marrëveshje sigurimi) një interes ndërkombëtar i tretë (një marrëveshje e dytë sigurimi), vartësi (e interesit ndërkombëtar tek i pari) dhe një caktim i një ose disa interesave ndërkombëtarë). Një "sesion regjistrimi" do të vazhdojë deri në 24 orë për qëllimin e "pagesës së regjistrimit".

1.6 Kjo pagesë e regjistrimit të vetëm do të përkufizohet si "pagesa e regjistrimit", shuma e së cilës parashtrohet në tabelën 1.

1.7 Motorët rezervë (d.m.th. motorët e tjerë përtej numrit që i përshtatet normalisht një korpusi avioni), që do të regjistrohen me një korpus avioni gjatë sesionit të regjistrimit të vetëm do t'i nënshtrohen një "pagese për motorë rezervë", shuma e së cilës përkufizohet në tabelën 1.

Pagesa e kërkimit

1.8 Një pagesë e vetme kërkimi do të faturohet për të gjitha kërkimet e bëra gjatë "sesionit të kërkimit" të përkufizuar për nënkuptimin "të gjitha kërkimet", që lidhen me:

- a) një korpus avioni dhe të gjithë motorët që përdoren rregullisht në të (ose ndonjë



nënbashkësi e tyre apo ndonjë motor i veçantë); ose

b) një helikopter.

Për këtë qëllim, "të gjitha kërkimet" nënkuptojnë të gjitha kërkimet që lidhen me objektin ose me objektet e parashtruara në klauzolat (a) ose (b), siç konfirmohet në formë elektronike nga pala kërkuese. Kjo pagesë e kërkimit të vetëm do të përkufizohet si "pagesë kërkimi", shuma e së cilës parashtrohet në tabelën 1.

Tabela 1. Pagesat

Përshkrimi	
Pagesa (Në dollarë amerikanë)	
Pagesa për krijimin e përdoruesit (5-vjeçar)	500
Pagesa për krijimin e përdoruesit (1-vjeçar)	200
Pagesa për krijimin e 10 përdoruesve (5-vjeçar)	2500
Pagesa e regjistrimit	100
Pagesa për motorë rezervë	50
Pagesa e kërkimit	35
Pagesa për certifikatën e humbur	100

## 2. PROCEDURA PËR RREGULLIMIN E PAGESAVE

2.1 Në fund të periudhës fillestare (viti i parë i fazës operationale) pagesat do të rishikohen nga ana e autoritetit mbikëqyrës në konsultim me kontraktuesit. Më pas, pagesat e reja mund të caktohen nga autoriteti mbikëqyrës, bazuar në vëllimin e parashikuar në atë pikë, duke marrë parasysh:

- rezervat në para të kontraktuesit për kapitalin e punës;
- nivelin e sigurimit të kërkuar nga autoriteti mbikëqyrës.
- çdo buxhet për çështjet ligjore, që kërkohen nga autoriteti mbikëqyrës ose kontraktuesi mbi atë që përmban tabela e kostove;
- kostot e autoritetit mbikëqyrës;
- çdo rritje shërbimi të kërkuar nga autoriteti mbikëqyrës, i sugjeruar nga kontraktuesi;
- volumi i transaksionit i arritur nga regjistrimi dhe ndryshimi nga volumi i transaksionit të projektuar nga kontraktuesi;
- çdo faktor tjetër përkatës.

2.2 Të njëjtat mekanizma rishikimi të parashtruar në paragrafin 2.1 mund të realizohen në fund të vitit të dytë, të tretë dhe të katërt të operimit.

## 3. TVSH-JA IRLANDEZE

Përdoruesit do të ftohen të deklarojnë vendin e tyre të rezidencës si pjesë e profilit përdorues të tyre dhe, nëse janë të vendosur në Bashkimin Evropian, do t'u kërkohet një numër TVSH-je të shoqërisë që do të përcaktojë aplikimin e TVSH-së irlandeze (e aplikuar për përdoruesit irlandezë dhe të Bashkimit Evropian). Sipas legjislacionit aktual, TVSH evropiane nuk aplikohet për shërbimet që jepen jashtë Evropës (për rrjedhojë, përdoruesit jashtë BE-së nuk i nënshtrohen TVSH - së).